

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi e Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve K.E., F.E., E.E.1. dhe E.E.2. (është veçu procedura), për shkak të veprës penale Lëndim i rëndë trupor në bashkëkryerje nga neni 154 par.1 nënpar.5 lidhur me nenin 23 të KPK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e paraqitur nga pala e dëmtuar I.V. dhe ankesave të mbrojtësve të akuzuarve K.E., F.E. dhe E.E.1. të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë PKR.nr.169/2018 datë 13.09.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 06.11.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Refuzohen si të pabazuara ankesat e palës së dëmtuar I.V. dhe ato të mbrojtësve të akuzuarve K.E. dhe F.E., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.169/2018 datë 13.09.2018, përkitazi me të akuzuarit K.E. dhe F.E. **vërtetohet.**

II.Me rastin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit E.E.1., e sipas detyrës zyrtare, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.169/2018 datë 13.09.2018, vetëm sa i përket cilësimit juridik të veprës penale, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarin E.E.1. e shpallë fajtorë për shkak të veprës penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Lëndim i rëndë trupor në bashkëkryerje nga neni 154 par.1 nënpar.5 lidhur me nenin 23 dhe 25 të KPK-së, ndërsa dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) muaj, ia merr si të vërtetuar. Pjesa tjetër e Aktgjykimit mbetet e pa ndryshuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin PKR.nr.169/2018 datë 13.09.2018, i ka shpallur fajtor të akuzuarit: K.E., F.E. dhe E.E.1., për shkak të veprës penale Lëndim i rëndë trupor në bashkëkryerje nga neni 154 par.1 nënpar.5 lidhur me nenin 23 të KPK-së, ku secilit veç e veç iu ka shqiptuar dënimin dhe atë të akuzuarit K.E. i përcakton dënim burgimi në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) muaj, në të cilin dënim i llogaritet edhe qëndrimi në paraburgim prej dt. 29.07.2012 deri me dt. 02.07.2013, të akuzuarit F.E. i përcakton dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. 29.07.2012 deri me dt. 02.07.2013, edhe të akuzuarit E.E.1. i përcakton dënim burgimi në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) muaj, në të cilin dënim i llogaritet edhe qëndrimi në paraburgim prej dt. 29.07.2012 deri me dt. 02.07.2013. I dëmtuari I.V. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil. Obligohen të akuzuarit që ti paguajnë të gjitha

shpenzimet e procedurës sipas regjistrimit të shpenzimeve, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë secili veç e veç të paguaj shumë prej 250 (dyqindtë e pesëdhjetë) euro brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

-Mbrojtësi i të akuzuarit K.E. Av. H.R. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi ankesën ashtu që aktgjykimin e shkallës së parë ta anuloj dhe lëndën t'ia kthej Gjykatës së shkallës së parë ne ri procedurë dhe vendosje meritore ose ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar duke liruar të akuzuarin K.E. nga aktakuza.

-Mbrojtësi i të akuzuarit F.E. Av. K.B. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovoj si të bazuar në tërësi kurse aktgjykimin e ankimuar ta anulojë në tërësi ashtu që të akuzuarin F.E. të lirohet nga akuza ne mungesë të provave dhe fakteve.

-Mbrojtësi i të akuzuarit E.E.1. Av. I.S. për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta prish apo të vendos me aktgjykim lirues në raport me të akuzuarin E.E.1.

-Pala e dëmtuar I.V. për shkak të vendimit mbi dënim me propozim që të aprovohet ankesa e tij dhe ndaj të akuzuarve të shqiptohet dënim më i lartë.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në të cilën prezent ishin të akuzuarit K.E. dhe av. H.R., F.E. dhe av. K.B., E.E.1. dhe av. I.S., si dhe pala e dëmtuar I.V., kurse nuk prezantoi Prokurori i Apelit edhe pse i njëjti është ftuar me rregull. Mbrojtësit mbeten pran ankësavë të parashtruara me shkrim, ndera të akuzuarit mbështetën fjalën e mbrojtësve të tyre, gjithashtu edhe i dëmtuari I.V. mbeti pran ankesës së parashtruar me shkrim.

Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.478/18 të dt. 12.10.2018 ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e palës së dëmtuar I.V. av. E.K., aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarve të shqiptohet dënim më i lartë, ndërsa të refuzohen si të pa bazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve K.E. av. H.SH, F.E. av. K.B. dhe E.E.1. av. I.S..

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesat e palës së dëmtuar dhe ato të mbrojtësve të akuzuarve K.E. dhe F.E. nuk janë të bazuara, ndërsa për të akuzuarin E.E.1. u bë ri cilësimi i veprës penale.

Mbrojtja e të akuzuarit K.E., av. H.R. ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale me arsyetimin se aktgjykimi i ankimuar mbështetet në provë të pa pranueshme, në raportin e policisë apo në kallëzimin penal, në bazë të cilit gjykata ka konstatuar përgatitjen e veprës, ndarjen e roleve dhe si rezultat bashkëkryerjen edhe përkundër faktit se kallëzimi penal apo raporti i policisë nuk janë prova ne procedurë penale. Sipas mbrojtjes aktgjykimi përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nda neni 384 par.1 nënpar.1.12 lidhur me nenin 370 par.7 të KPRK-së ngase gjykata nuk ka paraqite qartë dhe në mënyrë të plotë faktet arsyet vendimtare nuk ka dhënë arsye se cilat fakte janë të vërtetuara e cilat të pavërtetuara dhe në bazë të cilave prova, pastaj nuk ka vlerësuar saktësinë e provave, nuk ka eliminuar kundërthëniet në mes të provave posaçërisht nuk e ka vlerësuar mendimin plotësues të ekspertit mjeko ligjorë A.G. dhen në ne seance me dt. 07.02.2018 duke mos e marre për bazë faktin se eksperti në mes tjerash ka theksuar se “nuk mund të deklarohet lidhur me shkallën dhe natyrën e lëndimeve, pasi që mungon dokumentacioni i plotë”. Sipas mbrojtjes shkeljet e ligjit penal kanë të bëjnë me faktin s n rastin konkret nuk formësohen elementet e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, ne rastin konkret ri cilësimi është dashur të bëhet si vepër penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 të KPPK-së. Ndërsa vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike sipas mbrojtjes ka të bëjë me këto arsye, dispozitvi i aktgjykimit ka tejkalluar aktakuzën sepse gjykata në dispozitiv, janë caktuar dhe janë ndarë rolet e të akuzuarve, marrëveshjet paraprake të tyre, veprimet e tyre, para, dhe pas kryerjes së veprës penale. Këtë e ka bërë në bazë të kallëzimit penal dhe raportit të policisë, ndërsa kallëzimi penal nuk është provë. Sipas mbrojtjes mënyra e shpjegimit dhe e arsyetimit të provave nga ana e gjykatës është në kundërshtim me provat dhe gjendjen faktike, pasi që provat gabimisht dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, janë interpretuar në dëme të akuzuarve. Dhe si pasoje e lëshimeve procedurale të cekura she shkeljeve ligjore, ka ardhur edhe deri te sanksioni i lartë penal i cili është tepër i lartë dhe në sh përputhje të plotë me veprimet e të pandehurit.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.E. av. K.B. kundërshton aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale me arsyetimin se gjykata nuk i ka qartësuar në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe arsye janë të vërtetuara apo gjendjen faktike të pa vërtetuar me mos vlerësimin në veçanti lidhur me saktësinë e provave ose provave kundërthënëse dhe nuk ka të dhëna për mospranim të propozimit të palëve për nxjerrjen dhe plotësimin e provave, konkretisht nuk e ka qartësuar aktgjykimin se si ka ndodhur ngjarja e gjithë kjo në mungesë të provave dhe fakteve ashtu që kjo gjykatë nuk është marrë fare me vërtetimin e ekzistimit të veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtorë. Sipas mbrojtjes gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë apo nuk është vërtetuar plotësisht edhe përkundër asaj se angazhimi i gjykatës në vërtetimin e gjendjes faktike asnjëherë nuk ka munguar, ne dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar i akuzuari shpallët fajtor për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza, ndërsa në arsyetim të aktgjykimit nuk kuptohen dhe arsyet dhe faktet për të cilat është shpallur fajtor i akuzuari, në arsyetim përqendrohen dhe

theksohen deklaratat e të akuzuarve e në veçanti të dëshmitarëve të cilët kanë deklaruar se ka ndodh një përleshje në mes të dy personave por assesi 3 persona , ndërsa i dëmtuari deklarohet se një person me ka ra me grushte dhe me një gjë sendi të hekurt. Për arsyet dhe faktet e cekura me saktësi konkludohet se në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar fare nuk është vërtetuar gjendja faktike ashtu që nuk është konstatuar gjendja por vetëm është përshkruar gjendja dhe pikërisht nga mos vlerësimi i gjendjes faktike edhe vendimi mbi dënim nuk ka asnjë bazë ligjore dhe si i tillë është i pajustificueshëm.

Mbrojtësi i të akuzuarit E.E.1., av. I.S. konsideron se dispozitivi, i aktgjykimit dhe arsyetimi i tij nuk është konform dispozitave të nenit 369 par.3,4,5,6, e 7 të KPPK-së, shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë qëndrojnë mes tjerash edhe për shkak se aktgjykimi ka të meta për shkak se të cilave nuk mund të ekzaminohen, dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, aktgjykimi nuk ka fare arsye apo ne të nuk janë treguar faktet kryesore, dhe si i tillë është i përpiluar në kundërshtim me dispozitat nga neni 370 par.7 i KPRK-së. Sipas mbrojtjes vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike konsiston në faktin se nga ana e gjykatës gabimisht është shpallur fajtor i mbrojturi i tij. Pasi që është gjykuar për veprën penale lëndim i rëndë trupor në bashkëkryerje nga neni 154 par.1 nën par 5 lidhur me nenin 23, mirëpo duke e pas parasysh që Bashkëkryerje quhet “Nëse dy apo me shume persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbesisht duke i kontribuar kryerjes se saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale”, shtrohet pyetja cilat ish-inkriminues të mbrojturit tim, a mund të cilësohet veprim inkriminues “pas telefonatës nga vëllai K. e merr me veturë dhe e dërgon në shtëpi”. Mbrojtja gjithashtu konsideron se edhe sanksioni i shqiptuar është shumë më i lartë se sa është i paraparë me ligjin penal për raste të tilla, por edhe është i lartë në krahasim me peshën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, shkallës e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, dhe se sipas mbrojtjes nuk janë vlerësuar drejte rrethanat lehtësuese.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë, ankesat e mbrojtjes si dhe shkresat e lëndës dhe vlerëson se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuara me ankesë por as shkelje të tjera të cilat kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare është e obliguar të shqyrtojë. I njëjti ka të paraqitura arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, është paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Ka vlerësuar saktësinë e provave kundërtënëse si dhe arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palës mbrojtëse si dhe arsyet me të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështjeje penalo-juridike e veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarve. Gjykata e shkallës së parë në aktgjykim ka dhënë arsyet për faktet vendimtare, ka arsyetuar secilën provë veç e veç duke i ndërlidhur me njëra tjetrën dhe duke e vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, sa i përket të akuzuarve K. dhe F.E.. Deri te kjo gjendje e vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë erdhi në bazë të provave materiale dhe jo materiale dhe atë duke dëgjuar të dëmtuarin I.V. i cili lidhur me kohën, vendin, mënyrën dhe rrethanat në të cilën është kryer vepra penale ka qenë i qartë dhe konkret dhe se dëshmia e tij është në përputhje të plotë edhe me provat materiale të administruara në shqyrtimin kryesorë siç është

ekspertiza mjeko ligjore nga dr. A.G., raporti i vendit te ngjarjes i dt. 28.07.2012, leximi i vërtetimit mbi marrjen e përkohshme te sendeve i dt. 29.07.2012, ku vërtetohet se nga i akuzuari E.E.2. janë konfiskuar dy shufra te hekurit nga vetura, shikimi ne foto album, vërtetimi mbi kthimin e sendeve i dt. 28.07.2012 që ka të beje m e kthimi e veturës BMV bashkëshortes së te akuzuarit E.E.2., raporti mbi ekzaminimin e veturës, leximi i mendimit te ekspertit mjeko ligjor i dt. 07.02.2018, aktpajtimi, raporti i oficerëve policorë dhe raporti i Institutit të psikiatrisë Forenzike si dhe nga provat jo materiale leximi i deklaratave te dëshmitarëve A.D. të dhënë në polici me dt. 08.08.2012 dhe në shqyrtimin gjyqësore me dt. 20.04.2013, deklarata e dëshmitarit F.H.1 e dhënë ne polici me 20.09.2012 dhe ajo e dëshmitarit F.H.2 e dhënë ne polici me dt. 08.08.2012 e që pa mëdyshje vërtetuan se në veprimet e te akuzuarve qëndrojnë te gjitha elementet e veprës penale për te cilën K. dhe F.E. janë shpallur fajtores nga Gjykata e shkallës së parë dhe te gjitha veprimet inkriminuese te akuzuarit E.E.1. në drejtim te veprës se ri cilësuar nga kjo Gjykatë. Nga këto prova të arsyetuara nga Gjykata e shkallës së pare u vërtetua se ne natën kritike me mjet te fortë nga pas është goditur i dëmtuari I.V. i cili po ashtu ka pasur lëndime ne pjesë të trupit duke mbetur i shtrirë për toke, se me te njëjtit ka pasur më herët mos marrëveshje, se sulmin ia kanë shkaktuar i akuzuari K.E. me të tjerët dhe se në veturën e te akuzuarit E.E.2. janë gjetur shufra te metalta. Ne fakt pjesërisht kjo vërtetohet edhe nga deklarata e vet të akuzuarve K.E. edhe F.E. e ku i njëjti ne deklaratën e dhënë në prokurori ka deklaruar ndër të tjera se i ka ra m boks ne pjesën e gjoksit, dhe me shufër te hekurit që e ka marrë te disa maqina te prishta që kanë qenë aty afër e ka goditur te dëmtuarin I. ne pjesën e kokës dy here por e din se i ka ren edhe dy tri here neper trup duke u arsyetuar se i dëmtuari ka pasur revolen ne brez. Edhe F.E. ne prokurori ka deklaruar se babai i tij K.u i ka ra me grushte I.it dhe me shufër te hekurit ne pjesët te kokës dhe neper trup. Sa i përket te akuzuarit F.E. për të cilin mbrojtësi pretendon se i njëjti nuk ka kryer veprën penale, kjo Gjykatë vlerëson se për tu përmbushur kriteri i bashkëkryerjes nuk nevojitet vetëm veprimi konkret gjegjësisht marrja pjesë në kryerje te veprës penale por edhe kontributi i kryerjes se sajë në ndonjë mënyrë tjetër apo siç është ne rastin konkret i akuzuari F. është pajtuar me veprimet e te bashkakuzuarit K.E.. Për te ekzistuar bashkëkryerja nuk do te thotë që pjesëmarrësit paraprkakisht të jenë marrë vesh por ka mundësi që momentalisht aty për aty merren vesh për tu bashkuar ne kryerjen e veprës penale. Pra në rastin konkret bashkëkryerja ekziston jo vetëm ne rastet kur tjetri merr pjesë ne veprimin e kryerjes por edhe kur ne ndonjë mënyrë tjetër thelbësisht kontribuon ne procesin e kryerjes se veprës penale përkatësisht ne realizimin e planit te përbashkët. Ndërsa bazuar ne shkresat e lëndës përkitazi me te akuzuarin E.E.1. kjo Gjykatë vlerëson së në rastin konkret ne veprimet e tij nuk mund te qëndrojnë elementet e veprës penale për te cilën ai është akuzuar gjegjësisht, Lëndim i rëndë trupor në bashkëkryerje nga neni 154 par.1 nënpar.5 lidhur me nenin 23

të KPK-së, por elementet e veprës penale te ndihmës në kryerjen e veprës penale, Lëndim i rëndë trupor në bashkëkryerje nga neni 154 par.1 nënpar.5 lidhur me nenin 23 dhe 25 të KPK-së. Kjo pasi nga shkresat e lëndës gjegjësisht nga provat e administruara dhe atë nga dëshmia e dëshmitarit A.D. dhe F.H.1. i cili ka deklaruar se ka pare veturën Golf 2 e cila është vozitura nga i akuzuari E.E.1. por edhe nga vetë dëshmitë e te akuzuarave dhe atë i akuzuari E.E.1. që ka deklaruar se ka shkuar për ta marrë vëllain e tij K.un pasi ky e ka thirrur ne telefon por për ti ikur përgjegjësisë ka deklaruar se nuk e ka ditur për ngjarjen që ka ndodhur ndërsa i akuzuari K. ka deklaruar se pas ngjarjes e ka thirru vëllain e tij tani te akuzuari E.1. dhe i njëjti pas 5 minutave a arritur dhe se për rastin i ka

treguar ne veturë e që edhe i akuzuari F. e ka pohuar te njëjtën. Nga këto prova u vërtetua se ne veprimet e te akuzuarit E.E.1. qëndrojnë te gjitha elementet e veprës penale te Ndhmës ne kryerjen e Veprës penale Lëndim i rëndë truporë pasi u vërtetua se me veprimet e tij gjegjësisht me mjetin – veturën e tij është mundësuar largimi i të akuzuarit nga vendi i ngjarjes duke e ndihmuar te akuzuarin K. që të kryej veprën penale gjegjësisht t'ia lehtësoj kryerjen e veprës penale pra veprimet e tij konsistojnë ne ndërmarrjen e veprimeve te tilla me te cilat nuk kryhet vepra penale por vetëm ndihmohet kryerja e saj e që veprimet e tij përbejnë ndihmën dhe këto veprime gjendjen jashtë veprimit te kryerjes dhe se ai me veprimet e tij kontribuon që vepra penale te kryhet. Nga provat e administruara e sidomos nga dëshmitarët e përmendur me lartë demantohen pretendimet e te akuzuarve se te njëjtit kanë ardhur me vonë dhe nuk kanë qenë ne dijeni sepse vetë dëshmitaret kane deklaruar se kanë parë te akuzuarit duke u larguar me dy vetura te cilat voziteshin nga te akuzuarit E.1. dhe E.E.2.. Ne rastin konkret kemi te bëjmë me ndihmë fizike gjegjësisht ofrimi ne dispozicion i veturës për tu larguar nga vendi i ngjarjes ku është kryer vepra penale dhe te ky rast kemi të bëjmë me ndihmë direkte bashkëkryerësve te veprës bazë. Prandaj bazuar nga këto që u cek me lartë edhe u ri cilësua vepra penale për te akuzuarin E.E.1. si e dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Meqë aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal e që do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të palës së dëmtuar dhe mbrojtësve te akuzuarve nuk janë të bazuara. Në ankesën e tyre nuk theksohen prova te reja e te cilat nuk i ka pasur Gjykata e shkallës së parë kështu që duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese dhe renduese te vlerësuara drejtë nga ana e Gjykatës se shkallës së pare edhe atë për te akuzuarin K.E. se është : familjarë dhe mbikëqyrës i familjes , ka pranuar veprimet-sulmet ndërsa si rrethana renduese : pjesëmarrjen ne kryerjen e veprës penale e duke e pasur parasysh edhe moshën relativisht te vjetër te tij, lëndimet e renda te shkaktuara te dëmtuarit, duke e sulmuar nga pas ne befasi si dhe faktin se pas këtij rasti përsëri ka ndodhur rrahja ndërmjet këtyre dy familjeve. Për te akuzuarin F.E. : sjellja e mire e tij, me par i pa gjykuar, ne kohen e kryerjen e veprës penale ka qenë madhor i ri, ndërsa si rrethane renduese : rrezikshmëria shoqërore dhe pasojat e veprës penale. Për te akuzuarin E.E.1. si rrethane lehtësuese : gjendja e varfër ekonomike, i pa punë, ndërsa si rrethane renduese : mënyrën e kryerjes se veprës penale, pasojën e shkaktuar dhe pajtimin e tij që te kryhet vepra penale, vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 dhe 403 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

PAKR.nr.502/2018, më 06.11.2018

Procesmbajtësi,
Eroll Gashi

Kryetarja e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi_____

3. Abdullah Ahmeti _____